



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KËSHILLI QARKUT SHKODËR
KRYETARI**

V E N D I M

Nr. 02, Datë: 06.04.2022

“Mbi disa ndryshime në Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022 ”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 06.04.2022, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Mbi disa ndryshime në Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022 ”, bazuar në nenet 38 e 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.115/2021 “Per Buxhetin e Vitit 2022”, pikat 3 e 4 të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKQShkoder nr.17, datë 30.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022 dhe PBA 2022-2024”, VKQShkoder nr.14, datë 30.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2022 për Këshillin e Qarkut Shkodër”, VKB nr.3, datë 05.01.2022 të Bashkisë Shkodër, VKB nr.70, datë 29.12.2021 të Bashkisë Malësi e Madhe, VKB nr.72, datë 23.12.2021 të Bashkisë Vau Dejës, VKB nr.50, datë 23.12.2021 të Bashkisë Fushë Arrëz si dhe VKB nr.49, datë 30.12.2021 të Bashkisë Pukë, ; Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht nën 12,13, dhe 15 i saj.

Pas relatimit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **11 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**.

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022, pas miratimit të Kuotës së antarësisë, që Bashkitë e Qarkut Shkodër i financojnë Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022, kuotë e cila është planifikuar në buxhetet respective të Bashkive.

2. Kuota e Antarësisë, që bashkitë kanë planifikuar të financojnë Qarkun Shkodër për vitin 2022 do të jetë si më poshtë;

➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	600,000 lekë
➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	Totali	1,940,000 leke

3. Te behet shtesa e planit të të Ardhurave për vitin 2022 në Buxhetin e vitit 2022, të Këshillit të Qarkut Shkodër në shumën **1,940,000 lekë**.

4. Shuma **1,940,000 lekë** të përdoret për investimin **“Ndërtim I Ujësjellësit Muriqan”, Bashkia Shkodër**.

5. Të miratohet rishpërndarja e fondeve të trashëguara nga viti 2021, sipas tabelës së bashkangjitur dhe si më poshtë;

- a) Fondet e trashëguara nga viti 2021, Program 01110, Kap.1, Art. 600, në shumën **1,374,618 lekë** dhe në art.601 në shumën **259,051 lekë**, të pakësohen.
- b) Nga fondet e trashëguara nga viti 2021, në Program 01110, Kap.1, Art 602, shuma prej **4,069,960 lekësh**, të pakësohet.
- c) Fondet e mbetura në Programin 04980, Kap.5, Art. 604, në shumën **200,000 lekë**, të pakësohen.
- d) Fondet e mbetura në Programin 04760, Kap.1, Art.604, në shumën **77,960 lekë** të pakësohen.
- e) Fondet e mbetura në Programin 04760, Kap.5, Art.604, në shumën **183,994 lekë** të pakësohen.
- f) Fondet e mbetura në Programin 01110, Kap.1, Art.609, në shumën **950,000 lekë** të pakësohen.
- g) Fondet e mbetura në Programin 01110, Kap.1, Art.231, “Orendi zyrash” në shumën **21,873 lekë** të pakësohen.
- h) Nga fondet e mbetura në Programin 04520, Kap.1, Art.231, “Rikonstruksion i rrugeve ne Fushe Arrez” në shumën 431,675 lekë, shuma 144,298 lekë të shtohet ne invest.”Mbikqyrje rruga bardhaj Faza III” ndërsa shuma **287,377 lekë**, të pakësohet.
- i) Fondet e mbetura në Programin 01110, Kap.5, Art.231, “Rrethim e sistemim i varrezave ne

Pukë” në shumën 3,840,371 lekë, plan i perealizuar, të pakësohet.

j) Shuma e fondeve kesh, te pakësuar sa më sipër, ti shtohen investimit “Ndërtimi i Ujësjellësit në Muriqan” në shumën 7,452,123 lekë. Brënda Programit “Furnizimi me uje “ per investimin e “Ndërtimi i Ujësjellësit në Muriqan”, miratohet sistemimi i fondeve sipas tabelës së bashkangjitur.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .

7. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Hilmi LAKTI





KËSHILLI QARKUT SHKODËR
DREJTORIA E FINANCËS & BUXHETIT

Shkodër me _____ 2022

RELACION

DREJTUAR : Këshillit të Qarkut Shkodër.

OBJEKTI : Mbi disa ndryshime në Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022

Këshilli i Qarkut Shkodër për vitin 2022, bazuar nën 38 e 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.115/2021“Per Buxhetin e Vitit 2022”, pikat 3 e 4 të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017”Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKQShkoder nr.14, datë 30.12.2021, VKB nr.3,datë 05.01.2022 të Bashkisë Shkodër,VKB nr.70,datë 29.12.2021 të Bashkisë Malësi e Madhe, VKB nr.72, datë 23.12.2021 të Bashkisë Vau Dejës, VKB nr.50,datë 23.12.2021 të Bashkisë Fushë Arrëz si dhe VKB nr.49, datë 30.12.2021 të Bashkisë Pukë, propozon shtesë në planin e të ardhurave të vitit 2022, për financimin nga Kuota e Antarësisë që Bashkitë e qarkut Shkodër kanë planifikuar në buxhete e tyre per vitin 2022, për Këshillin e Qarkut Shkodër. Sipas pikës 3 të nenit 38 të ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore” i cili shprehet se “Qarku financohet nga kuotat e antarësisë së bashkive përbërese e cila përcaktohet në buxhet e tyre dhe që miratohet me Vendim të këshillit të Bashkisë, paraqesim para jush për miratim shtesën e planit të të ardhurave për vitin 2022 në zbatim të vendimeve të këshillave bashkiake dhe përkatsisht;

➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	600,000 lekë
➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	Totali	1,940,000 leke

Këto të ardhura, do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2022 dhe propozojme të përdoren për investimin **“Ndërtim I Ujësjellësit Muriqan”**, **Bashkia Shkodër**.

Nga fondet e mbetura të papërdorura nga viti 202, propozojme rishpërndarjen e fondeve , sipas tabelës së bashkangjitur dhe si më poshtë;

- a) Nga viti 2021, kanë mbetur pa u përdorë fondet ne zerin “Paga” në shumën **1,374,618 lekë** dhe në zërin “Sigurime Shoqërore” në shumën **259,051 lekë**. Propozojmë që këto fonde të pakësohen. Planifikimi i tyre është bërë duke konsideruar nje efekt te rritjes se tyre gjatë vitit 2021. Meqë pagat kanë mbetur të pandryshuara ka sjelle edhe fonde të mbetura në këto dy zera të buxhetit.
- b) Si rezultat i përdorimit me efijencë të shpenzimeve operative gjatë viti 2021, mbetejes se fondeve nga obligimi i fondeve të prokuruar, mosrealizimi i disa aktiviteteve për shkak të situatës së pandemisë, mosrealizimi i muzeumit etnografik per te cilin ka qenë iplanifikuar fondi ne shumen rreth 1,000 mijë lekë, nga fondet e planifikuara për shpenzime operative ka mbetura diferenca e papërdorur në shumën 4,870,460 lekë. Nga Nga këto fonde shuma prej 800,500 lekësh propozojme ti shtohet fondit të planifikuar per Sigurinë e objektit, pasi per vitin 2022, ka ndryshuar tarifa mujore e pageses, ne vitin 2021 ka qene 225,000 leke/muaj dhe për 7/muaj ndërsa për vitin 2022 tarifa mujore e pagesës është 329,127 lekë/muaj dhe për 8/muaj pagesë. Kjo ka sjelle edhe nevojën për shtesë fondi në këtë zë shpenzimi. Si rrjellojë nga fondet e trashëguara nga viti 2021, në Program 01110, Kap.1, Art 602, shuma prej **4,069,960** lekësh, propozojmë të pakësohet.
- c) Ngo fondet e mbetura në Programin 04980, Kap.5, Art. 604, shuma **200,000** lekë, propozojmë të pakësohet.
- d) Nga Fondet e mbetura në Programin 04760, Kap.1, Art.604, shuma e mbetur e papërdorur **77,960** lekë propozojmë të pakësohet.
- e) Fondet e mbetura në Programin 04760, Kap.5, Art.604, në shumën **183,994** lekë, propozojmë të pakësohen.
- f) Fondet e mbetura në Programin 01110, “Fondi Rezerve” në shumën **950,000** lekë, meqë nuk janë përdorë në vitin 2021, propozojmë të pakësohen.
- g) Fondet e mbetura në Programin 01110, Kap.1, Art.231, “Orendi zyrash”, si pasoje e diferencave nga prokurimi në shumën **21,873** lekë, propozojmë të pakësohen.
- h) Nga fondet e mbetura në Programin 04520, Kap.1, Art.231, “Rikonstruksion i rrugeve ne Fushe Arrez” në shumën 431,675 lekë, si pasoje e diferencës nga prokurimi, shuma 144,298 lekë të shtohet ne invest.”Mbikqyrje rruga bardhaj Faza III”, pasi ka mbetur e obliguar nga mosparaqitja e dokumenteve për likuidim e mbykqyerjes se punimeve ndërsa shuma **287,377** lekë, propozojmë të pakësohet.
- i) Fondet e mbetura në Programin 01110, Kap.5, Art.231, “Rrethim e sistemim i varrezave ne Pukë” në shumën 3,840,371 lekë, plan i parealizuar, propozojmë të pakësohet. Theksojmë se ky investim për dy vite 2020 dhe 2021 ka qenë i planifikuar të bëhet nga të ardhurat nga kuota e qarkut. Per vitin 2020, planifikimi ka qene 2140 mijë lekë dhe janë realizuar nga te


ardhurat nga kuota e qarkut vetem 140 mije lekë ndërsa për vitin 2021 kanë qenë planifikuar për këtë investim 1940 mijë lekë dhe janë realizuar 139.6 mijë lekë. Meqe realizimi i këtij investimi, në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar nga transferta e pakushtëzuar e vitit 2022 dhe është përfshirë në PBA-ne e vitit 2023, propozojmë që ky plan të pakësohet.

- j) Shuma e fondeve kesh, te pakësuar sa më sipër, ti shtohen investimit “Ndërtimi i Ujësjetllësit në Muriqan” në shumën 7,452,123 lekë. Brënda Programit “Furnizimi me uje “ per investimin e “Ndërtimi i Ujësjetllësit në Muriqan”, miratohet sistemimi i fondeve sipas tabelës së bashkangjitur.

Ketë Projekt –Vendim ju a paraqesim për MIRATIM.

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU



KESHILLI QARKUT SHKODER
Fonde te trasheguara nga viti 2021

Nr.	Art	Plani total	Keshi total	paksohen	Shtohen	Mbesin Plan	Mbesin cash
1	Shpenzime Paga	1,374,618	1,374,618	1,374,618		-	-
2	Shpenz. Sig. Shoqerore	259,051	259,051	259,051		-	-
3	Shpenzime operative	4,870,460	4,870,460	4,069,960		800,500	800,500
4	Transferime te brendshme	200,000	200,000	200,000		-	-
5	Transf. per bashkefinancime me BE	77,960	77,960	77,960		-	-
6	Transf. per bashkefinancime me BE	404,994	183,994	183,994		221,000	-
7	Fond rezervë	950,000	950,000	950,000		-	-
8	Orendi zyrtë	21,873	21,873	21,873		-	-
9	Mbikqyrje rruga Bardhaj Faza III	61,039	61,039	-	144,298	205,337	205,337
10	Rikonstr. + Asfaltim I rrugeve te Farrez	431,675	431,675	431,675		-	-
11	Rrethimi e sistemitimi I varrezave ne Puke	3,840,371	-	3,840,371		-	-
12	Ndertim ujesjellesi Muriqan	48,061,037	48,061,037		6,243,590	54,304,627	54,304,627
13	Ndertim ujesjellesi Muriqan	2,018,207	2,018,207			2,018,207	2,018,207
14	Superviz. Ndertim ujesjellesi Muriqan	43,547	43,547		1,208,533	1,252,080	1,252,080
15	Superviz. Ndertim ujesjellesi Muriqan	715,920	715,920			715,920	715,920
16	Kolaudim Ndertim ujesjellesi Muriqan	322,289	322,289	27,289		295,000	295,000
17	Kosto Projektimi per Ujesjellesin	1	1	1		-	-
	TOTALI	63,653,042	59,591,671	11,436,792	7,596,421	59,812,671	59,591,671

Nëpunësi Zbatues

Gjyjljana MIRUKU



KRYETARI

HILMI LAKTI

